

Të dhëna arkeologjike mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës¹

Adem BUNGURI

Instituti i Arkeologjisë

Akademia e Studimeve Albanologjike

Një aspekt i rëndësishëm i punës studimore për të hedhur më shumë dritë mbi epopën skënderbejane, është vendosja e korrelacioneve adekuate midis burimeve historike dhe atyre arkeologjike. Kjo gjë kërkon kryerjen e kërkimeve arkeologjike në kalatë, fortifikimet apo strukturat e tjera, që kronologjikisht i referohen periudhës në shqyrtim. Edhe pse është fjala vetëm për një periudhë 25 vjeçare (1443-1468), pra kohësisht mjaft e kufizuar dhe në terma arkeologjik vështirë e identifikueshme, çelësi i zgjidhjes, është studimi më i thelluar i burimeve arkeologjike dhe gjeografisë historike, si dhe bashkëpunimi midis studiuesëve të arkeologjisë dhe atyre të historisë mesjetare. Ky bashkëpunim është i nevojshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për monumente arkeologjiko-historik, kronologjikisht të lidhura me periudhën e Skënderbeut dhe bëhet i domosdoshëm edhe për faktin, se në studimet historiografike është shfaqur edhe ndonjë pikëpamje subjektive dhe voluntariste, që buron si nga mungesa e këtij bashkëpunimi ashtu edhe nga njohja e pamjaftueshme e terrenit². Kërkimet arkeologjike mbi fortifikimet e Skënderbeut kanë qenë të kufizuara vetëm në disa kala të kësaj periudhe apo struktura brenda tyre. Në periudhën 1964-2018 gërmime arkeologjike janë kryer në qytetin e Stelushit (1964-1966)³, qytetin e Lissosit (1968-1970)⁴, në kalanë e Krujës (1977-1980)⁵, në kalanë e fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit (1983-1985)⁶, në kalanë e Matricës në Rubik (2016)⁷ dhe janë kryer

¹ Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore kushtuar 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti Skënderbeut, Tiranë 01-02. 11. 2018.

² BIÇOKU 2002, 410-411; BIÇOKU 2003, 7-29; BIÇOKU 2005, 68; BIÇOKU 2006a 61-82; BIÇOKU 2006b, 79-82; BIÇOKU 2016, 89-121; 122-133; 163-168.

³ ANAMALI, 1967, 105-112.

⁴ PRENDI 1969, 241-247.

⁵ KOMATA 1982, 221-228.

⁶ SARAÇI 1987, 203-214.

⁷ HOXHA 2016, 151-171.


punime pastrimi të sistemit fortifikues të kalasë së Petralbës (Gur i Bardhë) nga Institutit i Monumenteve të Kulturës.

Objekt i këtij punimi janë rezultatet e vërtetimeve sipërfaqësore të kryera nga autori në disa nga fortifikimet e kësaj periudhe, topografikisht të lokalizuara në rajonin e Dibrës. Ai synon jo vetëm paraqitjen para opinionit shkencor të këtyre rezultateve, por edhe korrigjimin e ndonjë mendimi vulltarist që nuk i përgjigjet të vërtetës historike. Që në fillim duhet të vemë në dukje konstatimin tonë mbi përpunimin e plotë të përshkrimeve të Barletit me topografinë e kalave të Skënderbeut në terren, aq sa shpesh mbetesh i mahnitur nga detajet dhe saktësia e tyre. Kalatë dhe strukturat fortifikuese që lidhen me periudhën e Skënderbeut në rajonin e Dibrës, janë: Kalaja e Koxhaxhikut (Zhupë-Dibër), Kështjella e Modricit (Dibër), Kalaja e Skudrinës (Rekë-Dibër), Kalaja e fshehtë e Skënderbeut në Çidhën të Poshtme, Qyteti i Stelushit (Qafë-Murrë) në kufirin midis Dibrës dhe Matit, Qyteza e Valikardhës (Bulqizë) dhe Kulla e Skënderbeut (Vajkal-Bulqizë). Sipas vlerësimit kronologjik ato ndahen në dy kategori:

a. Fortifikime më të hershme prehistorike, antike të vona dhe mesjetare, gjegjësisht të periudhës së Skënderbeut.

b. Fortifikime të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut.

Në kategorinë e parë përfshihen: Kalaja e Koxhaxhikut, Kalaja e Skudrinës, qyteza e Valecardës, qyteti i Stelushit, ndërsa në kategorinë e dytë kështjella e Modricës, kalaja e fshehtë e Skënderbeut në Çidhën të Poshtme dhe kulla e Skënderbeut në Vajkal (fig. 1). Në këtë punim do të trajtohen shkurt disa prej monumenteve të mësipërm.



Harta e disa fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut

Fig. 1. Hartë e disa fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut,

1. Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)⁸ (x-41°44', y-20°59', z-1160m).

Kalaja e Koxhaxhikut ndodhet në krahinën e Zhupës, midis Dibrës dhe Strugës, në krahun e djathtë të Drinit të Zi, në skajin lindor të Dibrës (Maqedonia e Veriut). Ajo është vendosur në një kreshtë shkëmbore me lartësi absolute 1160m dhe relative 360m, që ngrihet në luginën midis fshatrave Koxhaxhik në juglindje dhe Breshtan në veriperëndim, malit të Stogovës në lindje dhe përroit të Koçistës në veri. (fig. 2-3). Kalaja ka një pozicion të favorshëm strategjik në zotërim të rrugës Ohër-Dibër. Nga sipërfaqja e saj kontrollohet lehtësisht i gjithë krahun i djathtë i Drinit të Zi, nga kodrat e Zhupës në jug deri në qytetin e Dibrës së Madhe në veri, nga kalonte rruga antike dhe ajo mesjetare Koxhaxhik-Dibër. Rruga e Drinit të Zi bashkon dy arteriet më të rëndësishme rrugore transballkanike të periudhës romake: vian Egnatia në jug (Ohër) dhe atë Lissus-Naissus në veri (Kukës). Duke qenë degëzimi verior i via Egnatias, rruga e Drinit të Zi përfaqëson një korridor mjaft strategjik për të gjitha periudhat prehistorike dhe historike.

Pozita topografike e kalasë së Koxhaxhikut përputhet plotësisht me përshkrimin e Barletit mbi qytetin e Sfetigradit, aq sa ngjan si fotokopje e tij. Ai e cilëson këtë qytet si „vend fort i mbrojtur dhe gati i paafrueshëm”,⁹ dhe tregon se „...vendi atje ishte aq i pjerrët, sa s'të zinte këmba dhe gjëkund e s'kishte ku të mbaheshe, veçse me ndonjë litar të fortë”¹⁰, dhe se: “rreth murevet s'kishte veçse një rryp shumë të ngushtë që ishte shesh, kurse pjesa tjetër e malit, që vinte menjëherë, ishte fund e krye një rrëpirë e hatashme”¹¹. Ai shkruan se “Qyteti (i Sfetigradit) ishte malor e i ndërtuar në majë të një shkëmbi shumë të lartë, pa asnjë burim uji përbrenda, por edhe pa ndonjë lum afër për ta përdorur. Kishte vetëm një pus brenda, të hapur e të ndërtuar në mes të qytetit, nga kujdesi i lashtë i popullit për dobi vetjake e të njerëzve dhe sidomos për nevojat e luftës... Roja e gjitha përbëhej nga ushtarë dibranë”¹². Sipas Barletit kështjella e Sfetigradit (Koxhaxhikut) ka pasur madhësinë e kështjellës së Stelushit si dhe një pozitë topografike krejt të ngjashme me të, gjë që është konfirmuar nga gërmimet arkeologjike¹³. Kalaja e Koxhaxhikut ruan gjurmë të banimit të saj gjatë periudhës së Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm, periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare, si dhe pjesë të sistemit fortifikues të dy periudhave të fundit.

⁸ Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar në vizitat e realizuara në këtë kala sipas viteve: 1983: Prof. Selim Islami (Tiranë) dhe Naim Fetahu (Dibër); 2006: Moisi Murra (Peshkopi), Pëllumb Naipi (Tiranë), Hysen Prapadniku, Qeram Lleshi, Sazan Prapadniku dhe Bardhyl Skara (Dibër); 2007: Sazan Prapadniku, Bardhyl Skara dhe Atli Dema (Dibër).

⁹ BARLETI (1537) 1964, VI, 235.

¹⁰ *Idem*, V, 198.

¹¹ *Idem*, VI, 237.

¹² *Idem*, V, 220.

¹³ ANAMALI 1967, 105-110.




Fig. 2-3 Pamje jugore dhe veriore e kalasë së Koxhaxhikut

a. Periudha e Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm (shek. XII-IX para Kr.)

Kësaj periudhe i takojnë disa fragmente enësh. Ata u gjetën në sipërfaqen e kalasë dhe në shpatet jugore të saj. Tre prej tyre janë punuar me brum të kuq argjilor, të përzier me kokriza rënore dhe guralecë të vegjël, me pjekje të njëtrajtshme por jo të plotë, me faqe të lëmuar mesatarisht, dhe ngjyrë kafe në të kuqëremtë, ndërsa ndeshen dhe ato me brum kafe

në bezhë. Përfaqësojnë tipin e enëve dyvegjake, me vegjë të ngritura mbi buzë (*fig. 4, 1-2, fig.5,1-2*), tip mjaft i përhapur në periudhën e Bronzit të Vonë dhe atë të tranzicionit Bronz-Hekur, si në territorin e Shqipërisë (Maliq III¹⁴, Nezir VI (Mat)¹⁵, Gajtan III¹⁶, Zagorë II (Shkodër)¹⁷ e të Kosovës (Vlashnje, Hisar)¹⁸, ashtu edhe në atë të Pelagoonisë (grupi pelagonas)¹⁹ etj. Vetëm një prej pareteve ruan dekorin shiritor në trajtë brinjësh plastike, të zbukuruar me shtypje gishti dhe thellime bigle (*fig. 4, 3, fig. 5, 5*), teknikë dekorative kjo mjaft karakteristike për poçerinë e epokës së Bronzit në Shqipëri²⁰ dhe në një areal mjaft të gjërë ballkanik²¹. Megjithëse mjaft të pakta, ata e cilësojnë kalanë e Koxhaxhikut si një vendbanim kodrinor të periudhës së Bronzit të Vonë dhe fillimit të epokës së Hekurit. Vendbanime të tilla të vendosura në maja kodrash dhe të fortifikuara me mure prehistorike, përfaqësojnë një tip të zakonshëm të fortifikimeve të Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm²², ku duhet të përfshihet edhe Koxhaxhiku, pavarësisht nga mungesa e fortifikimit prehistorik, që për shkak të mbrojtjes së fuqishme natyrore, duket se nuk ka qenë i nevojshëm.



¹⁴ PRENDI 1977-1978,13, tab. VIII, 2, IX, 5; PRENDI 1966, pl. XVII, 1, 6; PRENDI 1982, pl. IV, 9; PRENDI 1974, 107, tab. VIII, 1-5, IX, 3.

¹⁵ ANDREA 1990, 38, tab. XVI, 15-16.

¹⁶ JUBANI 1972, tab. X, 5.

¹⁷ ANDREA 1996, 31, tab. VII, 3.

¹⁸ BUNGURI-GASHI 2004, "AiA", Tiranë, Prishtinë; BUNGURI-GASHI 2006, "AiA", Tiranë, Prishtinë.

¹⁹ GARAŠANIN 1983b, 788, tab. CIX, 1-2.

²⁰ PRENDI 1977-1978, 13.

²¹ GARAŠANIN 1983a, 463-470, fig. 33, II, 1, 4 dhe III, 1, 4.

²² ISLAMI- CEKA 1965, 448-449.

Fig. 4-5. Fragmente enësh të Bronzit të Vonë (vizatime dhe foto)

b. *Periudha e vonë antike (shek. V-VI pas Kr.).* Kalaja ruan një sistem të thjeshtë fortifikues, që i përket periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare. Ky fortifikim gjendet në pjesën më të lartë të kreshtës shkëmbore të kalasë dhe përbëhet nga muri rrethues, një kullë katrore dhe hyrja pranë saj. Kreshta e kalasë mbyllet me një platformë të sheshtë afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet, që brenda mureve ka përmasa 58x34m, perimetër 145m dhe sipërfaqe rreth 1600m². Kjo platformë e fortifikuar, e njohur si “citadela”, ka rrënje plotësisht shkëmbore nga jugperëndimi, perëndimi dhe veriperëndimi, ndërsa nga anët tjera pjerrësia e shpateve të saj është shumë e madhe dhe thuajse e pangjithshme. Shtegu i vetëm që mundëson ngjitjen në kala, gjendet në anën verilindore të citadelës, prej ku realizohet komunikimi me varoshin dhe viset përreth. Linja e murit të citadelës ndjek vijën kufizuese të kreshtës, përveç anës jugore, ku përfshin brenda sipërfaqes së mbrojtur dhe dy tarraca të ngushta, të përshtatshme për banim. Muri shfrytëzon aftësitë mbrojtëse të terrenit, duke përfshirë brenda tij shkëmbinj të lartë natyrorë, kur ato gjenden në linjën e murit, dhe ndërpritet aty ku ka rënie të rrëpita e të pangjithshme dhe s’ka nevojë për mbrojtje. Sot ruhen 7 trakte të mureve rrethuese, që i kemi emërtuar sipas germave të alfabetit: A, B, C, D, E, F dhe G, me gjatësi përkatësisht 2.00m, 3.50m, 6.00m, 2.10m, 9.00m, 6.00m dhe 22m dhe perimetër të lexueshëm 50.60m. Gjendja aktuale e tyre paraqitet sipas tabelës së mëposhtme :

Trakti	Murri A	Murri B	Muri C Kulla	Murri D	Muri E	Murri F	Murri G	Shuma
Gjatësia	2.00m	3.50m	6.00m	2.10m	9.00m	6.00m	22m	50.60m
Lartësia	1.50m	1.20m	1.50	0.50m	3.00m	3.00m	0.40m	0.40-3.00m
Gjërësia	?	?	1.40m	?	1.70m	1.60m	?	1.40-1.70 m

Në kushtet e vërtetimit sipërfaqësor, është e vështirë veçimi tipologjik i murreve të periudhës së vonë antike prej atyre mesjetare, pasi muret e periudhës së parë janë mbuluar nga ato të mëvonshme, janë shembur ose dëmtuar. Megjithatë, duke u mbështetur në elementët më të sigurtë teknik, mendojmë se periudhës së vonë antike i përket muri i parë i

jashtëm i traktit C, me gjatësi të përgjithshme 6m. Është fjala për murin e jashtëm të kullës së vetme të fortifikimit, në të cilin ruhen dy fasada muresh që veshin njera tjetrën, të lidhura përkatësisht me periudhën e vonë antike dhe atë mesjetare. Gjithashtu me këtë periudhë mund të lidhen edhe gjurmë të shkëputura të murit jugor, të vendosura më në brendësi se sa muri mesjetar, por për të sqaruar këtë duhen kryer gërmime pastrimi. Muri është ndërtuar me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, sipas teknikës *opus incertum*. Llaçi është i një cilësie të mirë, i përzier me shumë rërë të imtë lumi dhe pak gëlqere paraprakisht të stazhionuar. Lartësia e ruajtjes së murrin lëviz nga 0.40-0.80m, ndërsa gjërësia e saktë, nuk mund të matet, pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat. Fortifikimi i periudhës së vonë antike, i konstatuar edhe nga studiuesë të tjerë²³, është aktualisht fortifikimi më i hershëm i kalasë së Koxhaxhikut. Megjithëse në ndonjë rast kjo kala është cilësuar edhe si “*aglomeracion urban i halshtatit ilir, i fortifikuar me blloqe gurësh kuadratik*”²⁴, nuk gjetëm gjurmë të fortifikimit të periudhave më të hershme ilire apo asaj urbane. Gjithashtu nuk gjetëm as fragmente enësh të periudhës së vonë antike.

c. Periudha mesjetare (shek. XIV-XV pas Kr.)

1. *Sistemi fortifikues*. Kalaja është rifortifikuar thuajse tërësisht në periudhën mesjetare, kur janë plotësuar pjesët e dëmtuara të mureve dhe janë rindërtuar trakte të reja të tyre. Ata në pjesën më të madhe të perimetrit mbivendosen mbi linjën e mureve të periudhës së vonë antike, plotësojnë pjesët e shembura të tyre, dhe në rastin më të mirë, i përforcojnë ato me këmisha të jashtme, siç ndodh në fasadën jugore të kullës së vetme të kalasë. Me këtë periudhë lidhen të gjitha traktet e ruajtura, A-G, me gjatësi 50.60 m, përfshirë këtu edhe murin e dytë të jashtëm të kullës të përmendur më lart. Murret janë ndërtuar sipas teknikës *opus incertum* me gurë lumor dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, të një cilësie të mirë. Llaçi përveç rërës së imtë të lumit përmban edhe shumë gëlqere të stazhionuar. Ai është përdorur me bollëk dhe përveç fugave me gjërësi 2-3cm, mbulon dhe një pjesë të faqes së jashtme të gurëve. Gurët nuk krijojnë rreshta horizontale dhe nuk nivelohen me copa gurësh të thyer. Gurët e fasadës së jashtme shpesh kanë rënë në faqet e kreshtës dhe murri nuk ruhet i plotë.

²³ Микүльчич 1999, 404.

²⁴ ВІТРАКОВА – GROŽDANOVA 1966, 199.



Fig. 6a-b- trakte të murit jugor E

Lartësia e ruajtjes së murit lëviz nga 0.40 deri në 2.50- 3.00m, ndërsa trashësia e tij, e matur me vështërsi vetëm në tri pika është 1.40-1.70m. Duhet theksuar se trashësia e murit është e vështirë të matet saktë, pasi faqja e brendshme e tij është e veshur nga dherat e pjerrësisë së kodrës.



Fig. 7-8. trakte të murit jugor F dhe D

Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është ndeshur kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Krujë (0.80-1.50m), në Shurdhah (1.30-2.60m), në Daulë të Krujës (0.75 m, 0.90 m, 1.10m, dhe 1.80m)²⁵, në Stelush(1.50-1.80m) dhe po aq në Petralbë(Gur i Bardhë)²⁶ etj.

Kulla e vetme juglindore me përmasa 6.00x6.00m, duket qartë se është rifortifikuar në periudhën mesjetare, pasi muri i periudhës së vonë antike, vishet në këtë periudhë në anën e jashtme jugore nga një mur i dytë përforcues, me trashësi 1.40m.

²⁵ SARAÇI 1987, 205; ADHAMI 1971, 87; SPAHIU - KOMATA 1974, 263.

²⁶ Sipas vrojtimeve të autorit në kalanë e Stelushit dhe në atë të Petralbës.



Fig.9-10-Muri I dhe II i jashtëm i kullës-trakti C

Hyrja e kalasë duhet të jetë në anën e majtë të kësaj kulle, pasi aty kalon shtegu i vetëm që lidh kalanë me varoshin. Në faqen e jashtme të murit jugor, në segmentin E shihet një vrimë cilindrike me diametër 6cm dhe thellësi të lexueshme 1.00m, e cila i takon mbetjeve të skelerisë metalike të ndërtimit (fig. 11). Vrima të tilla skelash, me formë rethore dhe përmasa të njëjta (6x6cm), që e përshkojnë murin në të gjithë trashësinë e tij, janë ndeshur edhe disa në fortifikime të tjera mesjetare të Shqipërisë, si në qytetin e Stelushit²⁷, kalanë e Ndroqit etj. Seksioni i tyre i njëjtë në të gjithë trashësinë e murit, dëshmon se për ndërtimin e këtyre skelerive janë përdorur tuba hekuri, teknikë e futur në ndërtimin e kalave nga arkitektët bizantinë.



Fig.11- pamje e vrimës së skelerisë së ndërtimit . Fig. 12-trakt i murit të një godine brenda citadelës

²⁷ Sipas vërejtjeve të autorit në murin e dytë rrethues të kalasë së Stelushit.

Në pjesën e brendshme veriore të “citadelës“ gjenden rrënojat e një godine, prej të cilës shihet vetëm një trakt muri me gjatësi 1.70m, dhe lartësi të faqes së jashtme 1.10m. Gjërësia nuk mund të matet saktë pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat, por nuk e kalon 1.00m. Teknika *opus mixtum* e ndërtimit të tij ndryshon nga ajo e murreve rrethuese. Në strukturën e tij, përveç gurëve, gjenden rrallë edhe tulla me trashësi 4cm, të periudhës së vonë antike, të ripërdorura pa ndonjë regull, të lidhura me llaç gëlqeror me shumë gëlqere dhe pak rërë (fig. 12). Paraprakisht mund të supozohet se godina mund të lidhet me ndonjë objekt kulti, ndoshta me kishën e Shën Mërisë²⁸, por kjo mbetet të konfirmohet ose jo nga gërmimet e ardhshme. Në anën jugore të kalasë, në pjesën më të ulët të saj dhe njëherësh më të mbrojtur nga erërat, gjenden gjurmë themelesh të godinash me gjërësi 0.60m, sa duket me karakter ushtarak.

²⁸ BARLETI 1537 (1964), IV, 192. "Perlati (Pjetër Perlati-komandant i Sfetigradit-AB) mori masat....pastaj, nga një portë e vogël, që e ka emrin "Dibrane", i priti barbarët në qytet. U fut brenda vetëm purpurati (një nga këshilltarët e sulltan Muratit II-AB) bashkë me tre ushtarë dhe dy shërbëtorë, të cilët përmes sheshit të qytetit, i shpuri në faltoren e Shën Mërisë, ku, pasi thiri më pleqtë e qytetit, urdhëroi të bëhej mbledhja".




Fig. 13. skicë planimetricke e kalasë së Koxhaxhikut

Gjithashtu në gjysmën jugore të syprinës së saj gjenden pranë njeri tjetrit dy gurë të mëdhenj natyrorë, me sipërfaqe të sheshtë, që ruajnë në mesin e tyre nga një vrimë cilindrike me përmasa $0.30 \times 0.30 \times 0.20\text{m}$ dhe $0.20 \times 0.16 \times 0.15\text{m}$, të përdorura si dybeqe për shtypjen e barutit²⁹ (fig. 14), identik me një gur të tillë të zbuluar së fundmi në Kullën e Skënderbeut në Vajkal (Bulqizë).

²⁹ LLESHI 2005, 205, fig. 8.




Fig.14- pamje e dybekut nr. 1 të kalasë.

Në pikëpamje kronologjike, besojmë se fortifikimi mesjetar i kalasë së Koxhaxhikut lidhet me periudhën e Skënderbeut dhe është i njëkohshëm me fortifikimet e kryera prej tij në Krujë, Petrelë, Guri i Bardhë (Petalbë) dhe Stelush³⁰. Me këtë periudhë përputhen teknika e ndërtimit të mureve rrethuese e përshkruar më lart, trashësia e vogël e tyre, mospërdorimi i tullave në përbërje të murreve, cilësitë teknike të llaçit, që shquhet për mbizotërim të gëlqeres në raport me rërën, përdorimi i skelerive prej tubash hekuri, si edhe shumica e materialit të imtë qeramik të gjetur në këtë kala. Në periudhën mesjetare kalaja mendohet të ketë qenë pajisur dhe me dy kalime të nëndheshme në trajtë tunelesh sekrete, element ky i pranishëm në mjaft fortifikime mesjetare.

2. *Varoshi*. Në anën verilindore të kalasë, pas një qafe të ngushtë, në një disnivel kuatash prej afro 20m, hapet një tarracë e gjërë me kushte mjaft të përshtatshme për banim, e njohur me emrin “*varosh*”. Është zbuluar për të parën herë nga autori i këtij punimi. Në këtë tarracë me sipërfaqe afro 0,7ha (diametri veri-jug-145m, diametri lindje-perëndim-47m) shtrihej qyteti mesjetar, i lidhur organikisht me kalanë. Edhe varoshi ka një pozitë të shkëlqyer natyrore dhe mjaft strategjike. I mbrojtur nga perëndimi dhe veriu prej rrënjëve shkëmbore të faqeve të tij, ai ka një pjerrësi të lehtë lindore. (fig. 13, 15a). Në varosh ruhen gjurmë të shumta banesash me formë katërkëndëshe, të orientuara nga lindja, zakonisht të mbështetura në shkëmbenj natyror. Në pjesën qendrore më të dukshme të tij, shihen themelet e një godine katërkëndëshe me përmasa të jashtme 7.00 x4.50 m, të shënuara nga gurë të mëdhenj, me gjërësi 0.90m (fig. 15b).

³⁰ KARAISKAJ 2016, 155: "Fortifikimet në të cilat vuri dorë Skënderbeu, ishin në radhë të parë: Kruja, Petrela, Guri i Bardhë (Petalba), Stelushi e Sfetigradi".



Fig. 15a-Pamje e varoshit;



Fig. 15b- themele godinash në varosh

Ana lindore e varoshit kufizohet nga gjurmët e një murri të gjatë tarracimi, që ka shërbyer si trase edhe për rrugën e karrove që ngjitej në varosh, e cila është qartë e dukshme (fig. 16).



Fig.16- traseja e rrugës së varoshit

Trakte të kësaj rruge shihen edhe në lëndinën fushore në jug të kalasë, ndërkohë që bashkimi i tyre nëpër shpatin e pjerrët të kodrës, në terren ende nuk është gjetur. Gjurmë të banesave apo të godinave të ndryshme, ruhen gjithashtu edhe në rrëzën jugore të kreshtës së kalasë, jashtë varoshit, aty ku fillon lëndina e madhe fushore prej disa hektarësh. Duket se ato janë vendosur atje në kohën e lulëzimit të qytetit, kur ai njohu rritjen më të madhe të tij. Sipas studiuesëve, qyteti ka qenë furnizuar me ujë të pishëm nga gurra “Kërmzesu”(turqisht-uji i kuq) e kodrës Byk-Duruk, vetëm 4km në lindje të kalasë³¹. Ujësjiellësi përbëhej prej qyngjesh qeramike, fragmente të cilave janë gjetur herë pas here

³¹ LLESHI 2005, 200; MURRA 2005, 134.

nga banorët lokalë, por të paruajtura, për vlerësimin e tyre kronologjik. Furnizimi i kalave mesjetare me uji nga burime të jashtme realizohej me tubacione qyngjesh qeramike, ndërsa ruajtja e tij me anë sterash të ndërtuara me kujdes brenda zonës ushtarake³².

3. *Varreza* . Në rrafshinën e madhe kodrinore që shtrihet në jug të kalasë së Koxhaxhikut, shtrihet një varrezë e madhe me sipërfaqe mbi 2ha. Ajo përbëhet nga varreza e poshtme në jug dhe ajo e epërme në veri, me ndryshime të qarta midis tyre, si në aspektin arkitektonik ashtu edhe në atë konceptual, religjioz dhe kronologjik. Sipas një vlerësimi paraprak, ata duket se lidhen me dy periudha të ndryshme përdorimi, që kronologjikisht u referohen shek. XV dhe XVIII pas Kr. Periudhës së parë të shek. XV-të, mendojmë se i përket varreza e poshtme, në pjesën jugore të lëndinës së varreve. Ajo përbëhet nga qindra varre me konstruksion të njëjtë dhe orientim lindje-perëndim. Varret janë konturuar me gurë në të gjitha anët, pa gurë të veçantë kufizues te koka dhe te këmbët. (fig. 17a). Krahas varreve individuale, ka edhe shumë varre masiv. Ato kanë formë drejtkëndëshe ose katërkëndëshe dhe ndryshojnë vetëm nga përmasat e tyre, disa prej të cilave janë: 2.00x2.90m, 3.50x4.00m, 4.00x5.50m, 4.00x6.00m, 6.00x4.50m, 5.00x8.80m etj. (fig. 17b). Megjithëse e pastudiuar në pikpamje arkeologjike, varreza e poshtme hap diskutime dhe shtron nevojën e gërmimeve arkeologjike³³. Periudhës së dytë të shek. XVIII-të, i takon varreza e epërme, e vendosur në pjesën veriore të lëndinës së varreve, ku përdoret tipi i varrit individual me gurë kufizues vetëm tek koka dhe këmbët, në disa prej të cilëve gjenden edhe epitafe në osmanisht.



Fig. 17a-Pamje e pjesshme e varrezës së poshtme Fig. 17b- Pamje e pjesshme e varreve masive

³² KOMATA 1982, 225-226, fig. 6-7; KARAISKAJ 1985, 59 vv, fig. 5.

³³ Mundësia hipotetike e lidhjes së varrezës së poshtme me mesin e shek. XV pas Kr. është e pakonfirmuar arkeologjikisht dhe mbështetet vetëm në tipin konstruktiv të varreve si dhe në parimin logjik se varret e masive përdoren vetëm në raste lufrash, sëmundjesh epidemike apo fatkeqësishë natyrore.

4. *Qeramika*. Periudhës mesjetare paraosmane (shek. XIV–XV pas Kr.) i përkasin fragmentet më të shumta të enëve, të mbledhura në sipërfaqeen e kalasë e të varoshit, si dhe në shpatet lindore e jugore të kreshtës së saj. Në pikpamje teknologjike, veçohen dy grupe enësh :

a. Enët e grupit të parë, që mbizotërojnë, janë punuar me baltë bezhë në gri dhe gri në të zezë, të pastruar nga lëndët e huaja, dhe kanë pjekje e lëmim të mirë. Janë kryesisht enë kuzhine, të përdorura për zierje dhe shpesh ruajnë njollat e tymosjes dhe të zjarrit.

b. Enët e grupit të dytë me baltë të okër të hapur në rozë, janë më të ralla. Kanë brum të pastër me ngjyrë rozë, pjekje e lëmim të mirë dhe paraqiten të zbukuruar me pikturim paste të bardhë. U takojnë enëve të tavolinës dhe të pijes. Format kryesore të enëve të grupit të parë janë vorbat, që ndeshen në dy variante : vorba me grykë konike dhe buzë të profiluara për puthitjen e kapakut, me përdorim më të gjërë (*fig. 18a, 1-5; fig. 18b, 1-5, 7-8*) dhe vorba me grykë konike dhe buzë të hapura anash (*fig. 18a, 6; fig. 18b, 6*). Të dy variantet mbështeteshin mbi funde të sheshtë apo lehtë konkav (*fig. 19a, 1-3*). Ato janë pajisur me vegjë shiritore vertikale, që dalin nën grykë, në ndonjë rast të zbukuruar me thellime thike (*fig. 19a, 4-5*). Një pjesë e vorbave paraqiten të zbukuruar me inçizim vijash të çarkut, që e qarkojnë enën horizontalisht (*fig. 19a, 6-10; fig. 19b, 1-4*). Në një rast të vetëm ndeshet kombinimi i vijave të çarkut dhe një rreshti thellimesh me bigël, dekor ky i njohur në kulturat tona mesjetare të shek. XII-XIV³⁴. (*fig. 19a, 11; fig. 19b, 5*) si dhe shiriti plastik i zbukuruar me gropëzime gishti (*fig. 19b, 6*). Vorba të ngjashme, të zbukuruar me këto motive, janë zbuluar gjithashtu në kalatë e Skënderbeut në Stelush (Qafë-Murrë)³⁵, në Gurin e Pishkashit (Prenjas), në kalanë e Petrelës (Tiranë) dhe në qytetin e Shurdhahut³⁶, në kalanë e Krujës³⁷, në kalanë e fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Krujës³⁸, në gradishtën e Symyzës (Korçë)³⁹ etj, të datuara në shek. XIV-XV pas Kr. Në grupin e dytë të qeramikës me brum okër në rozë, përmendim qafën e një kane me grykë konike, me brum të pastër rozë, të zbukuruar me pikturim mat të bardhë shiritash horizontal e vertikal (*fig. 19a, 8; fig. 19b, 9*).

³⁴ KOMATA 1969, 222-226, tab. VII, 1-7, 10-14, VIII, 16-17, 20-23; KARAISKAJ 1979-1980, tab. IX, 3.8.

³⁵ ANAMALI 1967, 4, 106 ; ANAMALI 1969, 249 – 253

³⁶ KOMATA 1969, 222-226, tab. II, 1, 4, 6, 7 ; IV, 1, 3, 7 ; V, 1-4 ; VII, 1-4, 8, 10, 11; VIII, 4..

³⁷ KOMATA 1982, tab. V, 1-4, 7, 9-10.

³⁸ SARAÇI 1987, 211-212, tab. II, 1-7, III, 1-7, IV, 1-6.

³⁹ KARAISKAJ 1979-1980, tab. IX, 3.




Fig. 18a- Fragmente enësh mesjetare Fig. 18b- Foto enësh mesjetare





Fig. 19a- Fragmente fundesh e dekoresh Fig. 19b- Foto dekoresh të enëve mesjetare

Tipi i kanave me qafë të gjatë vazhdon nga qeramika e vonë antike në atë mesjetare dhe ndeshet në kalanë e Stelushit, të Pishkashit dhe të Petrelës⁴⁰, në kalanë e Krujës⁴¹, si dhe në vise të tjera të Ballkanit⁴². Nga brumi dhe analogjitë, përfaqëson një import me origjinë nga Mesdheu Lindor, gjasisht nga punishtet qeramike të Qipros dhe datohet pas shek. XIV⁴³. Të njëjtës periudhë i përkasin edhe dy fragmente enësh të zbukuruara me pikturim shiritash të bardhë (fig. 19b, 10-11) si dhe dy vegjë shiritore vertikale, me zbukurim të thellimesh thike në qendër të kombinuar me shirita anësor të pikturuar me pastë të bardhë (fig. 19b, 7-8).

Të dhënat arkeologjike të paraqitura më lart, dëshmojnë se kalaja e Koxhaxhikut përfaqëson një kala ilire të periudhës së Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm. Në periudhën e vonë antike ajo fortifikohet për herë të parë me mure mbrojtëse, dhe rifortifikohet në periudhën mesjetare gjatë shek. XIV-XV pas Kr. Kjo është edhe periudha më intensive e jetës në këtë kala, ku mendojmë se është plotësisht i mundur lokalizimi i qytetit mesjetar të Sfetigradit, çështje e trajtuar në një punim të mëparshëm⁴⁴. Këto të dhëna arkeologjike rrëzojnë pohimin e pavërtetë të K. Biçokut se: ***“Pranë këtij fshati është një shkëmb i lartë që ka shërbyer si pikë vrojtimi. Thuhet se aty ka qenë kalaja...Në Koxhaxhik nuk ka gjurmë kështjelle të ndërtuar me gurë dhe as që mund të ngrihej një kështjellë e tillë në një lartësi aq të madhe. Në Koxhaxhik kështjella ka qenë prej druri”***⁴⁵.

⁴⁰ KOMATA 1969, 226.

⁴¹ KOMATA 1982, 1, 227, tab. II,1-2.

⁴² KOMATA 1969, 226, shën. nr. 21.

⁴³ STERN 1997, 48-50, fig. 9, a-b.

⁴⁴ BUNGURI 2009, 27-56.

⁴⁵ BIÇOKU 2003, 26-27, 29. Këtë pohim të pasaktë, ai vazhdon ta mbrojë edhe në një punim të viteve të fundit, ku shkruan: *“Pranë këtij fshati në veri është një shkëmb i lartë (kur i sheh anën perëndimore), të cilin, kur e sheh nga lindja, i shquhet maja e thepisur e një kodrine, të cilës mund t'i ngjiten vetëm alpinistët dhe në të nuk ka gjurmë ndërtimesh”* (Krhs. BIÇOKU 2016, 89), përfundim që e përsërit edhe disa rreshta më poshtë: *“Nuk ka gjurmë guri të kështjellës së Koxhaxhikut, edhe pse ajo është përmendur deri në fillim të shek. XVIII, çka tregon se ajo nuk ka qenë ndërtuar me gurë”*. (Krhs. BIÇOKU 2016, 91-92). Pavarësisht pohimeve të tilla antishkencore, kalaja e Koxhaxhikut është aty dhe ruan pjesë të sistemit të dikurshëm fortifikues, që mund të shihen nga kushdo që ka dëshirë të merret me studimin e kësaj kalaje. Identifikimi ose jo me Sfetigradin, megjithëse për mua është jashtë çdo dyshimi, është çështje dytësore dhe e diskutueshme midis studiuesëve. E rëndësishme dhe e detyrueshme për studiuesit është paraqitja e saktë e monumentit të cilit i referohemi, pasi liria e mendimit është relative dhe lypset të jetë në koherencë të plotë me faktet arkeologjike dhe historike.

2. Kështjella e Modricës (Dibër)⁴⁶ (x-41°36', y-20°57', z-996m)

Kështjella e Modricës⁴⁷ ndodhet në majën e një kreshte shkëmbore me lartësi 996m, afër fshatit homonim, në krahun e majtë të Drinit të Zi dhe përroit të Modriçës (Maqedonia e Veriut). E ngritur përballë kalasë së Koxhaxhikut, me të cilën ka komunikim pamor, fortesa ka një pozitë të zgjedhur strategjike dhe kontrollon luginën e Drinit dhe rrugën Ohër- Dibër. (fig. 20). Kreshta ku gjendet fortifikimi ka mbrojtje të fortë natyrore, sipërfaqe të vogël rreth 300m², perimetër 102m, diametrin veri-jug 50m dhe atë lindje-perëndim 45m. Ajo ka qenë e fortifikuar me murre, gjurmët e rrënuar të të cilit mund të ndiqen vetëm në anën lindore dhe atë verilindore, në një gjatësi prej 26m. Murri ka shfrytëzuar aftësitë mbrojtëse të terrenit dhe ka mbushur hapësirat midis shkëmbinjëve natyrorë. (fig.21, 23). Trakti më mirë i ruajtur, me gjatësi 2.00m, lartësi 0.80m dhe gjërësi 1.00m gjendet në anën verilindore, pranë sterës. Muri është ndërtuar sipas teknikës *opus incertum* me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç gëlqerorë të përzier me rërë zalli të pasitur, cilësisht mjaft i dobët, gjë që ka ndikuar në mosruajtjen e linjës së murit. Kjo veçori teknike tregon për ngutje në ndërtimin e saj (gëlqerja është përdorur menjëherë pas shuarjes), gjë që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, kjo fortesë u ndërtua me nxitim nga Skënderbeu, pas rënjes së Sfetigradit, për të kontrolluar vijën e Drinit të Zi, që për Skënderbeun kishte rëndësi strategjike⁴⁸. Përshkrimi i kësaj forte nga Barleti është i gjallë dhe i plotë : “ *Ishte një mal, banorët e quajnë Modrisë, thikë e rrëpirë, i cili, për shkak të lartësisë së vetë, vështronte përpara tokat e turqve në një hapësirë të madhe. Atje ai vendosi të ngrinte një kështjellë, dhe ta mbushte me luftëtarë, të cilët, me krismën e përdredhoreve të lajmëronin kur të vinin armiqtë. Atje do të shkonin për strehim edhe gjithë sa ishin afër* ”⁴⁹. Më poshtë ai shton se ndërtimi i kështjellës „ *filloi e mbaroi në qetësinë më të madhe, pa ngjarë gjë*

⁴⁶ Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar në vizitat e realizuara në këtë kala sipas viteve: 1983: Fisnik Cami, Nazif Tominaj (Dibër); 2006: Moisi Murra (Peshkopi), Pëllumb Naipi (Tiranë), Hysen Prapadniku, Qeram Lleshi, Sazan Prapadniku dhe Bardhyl Skara (Dibër).

⁴⁷ Fortesa e Modricës është vizituar nga Jastrebov (Krhs. JASTREBOV 1904, 125) dhe më vonë nga H. Sharofi, i cili shkruan se : “ *Skënderbeu për ti bërë ballë rezikut që i shkaktonte humbja e Sfetigradit, themeloi dhe ndërtoi me të shpejtë fortesën e Modriçës, në krah të majtë të Drinit, ballë për ballë me Sfetigradin, që ishte në krah të djathtë të Drinit. Kjo fortesë e mbyllte grykën e Drinit dhe kontrollonte lëvizjet e ushtrisë turke e i lajmëronte kështjellat e tjera me anë të topit* ”.(Krhs. SHAROFI (1968), 2003, 49) etj.

⁴⁸ Duke treguar për lëvizjet e ushtrisë së Skënderbeut kundër kampit armik në Ohër, pas rënjes së Sfetigradit, Barleti shkruan se : “ *ai (Skënderbeu) në të ngrysur të asaj dite u nis me më shumë se 1000 kalorës për në Ohër, duke e hequr ushtrinë me shumë kujdes përmes disa pyjeve dhe vendeve të papërshtatshme, për të mos u mbyllur nga armiku në mes të Sfetigradit dhe të rojeve të tij* ” (Krhs. BARLETI (1537) 1964, IX, 383).

⁴⁹ BARLETI 1537 (1964), VII, 293.

gjatë asaj kohe nga ana e armikut,⁵⁰. Në anën verilindore të fortesës, u gjet një sterë uji me planimetri drejtkëndore, me brinjë 1.80x2.50m, thellësi të matshme 3.30m⁵¹ dhe vëllim mbi 14,85m³, me një kapacitet ujëmbajtës rreth 15.000 litra. (fig.22). Gjërësia e murreve të sterës është afër 1.00m. Hapësira e brendshme e saj është e suvatuar me llaç horasan hidroizolues, i bërë me pluhur tjegullash, shumë i fortë dhe i papërshkueshëm nga uji, që ka krijuar një shtresë të forte në trajtë graniti, me ngjyrë të kuqërremtë. Në kontekst me sistemin fortifikues, kjo sterë është përgatitur me të gjithë kujdesin e mundshëm. Një gjë e tillë është e shpjegueshme, po të kujtojmë se kjo fortesë i vlente Skënderbeut kryesisht si pikë vrojtimi, ku nevoja për ujë të pijshëm ishte e përhershme. Në këtë kështjellë, sipas burimeve historike, u instalua nga Skënderbeu për herë të parë sistemi i ndërlidhjes me top, ose siç e quan Barleti “përdredhore”⁵². Edhe për lokalizimin e kësaj kështjelle, është propozuar një toponim i palokalizuar në krahinën e Tetovës⁵³, që nuk i përgjigjet as gjeografisë historike dhe as përshkrimeve të Barletit.



Fig. 20. Pamje e kështjellës së Modricës



Fig. 21. Gjurme të murit lindor të kështjellës së

⁵⁰ *Idem*, VII, 293. Studiuesi Gj. Karaiskaj mendon se kështjella e Modricës është ndërtuar menjëherë pas rrethimit të parë të Krujës, rreth viteve 1451-1452. Ai thekson se kështjella e Modricës, ndodhej në kufirin lindor të Shqipërisë, akoma e paidentifikuar. Krhs. KARAISKAJ 2016, 157.

⁵¹ DysHEMEJA e sterës është e zënë nga shembjet e gurëve dhe dherat.

⁵² BARLETI 1537 (1964), VII, 293.

⁵³ Përmendet një toponim i palokalizuar në krahinën e Tetovës "të përafërt me trajtën e emrit Modrishë të M. Barlecit", "që mund të lexohet: Mdrushte, Modorishte, Morovishte dhe Medrovishte". Krhs. BIÇOKU 2016, 130, shën. 407.



Fig. 22. Pamje e sterës së ujit të Modricës Fig. 23. Skicë planimetrike e fortesës së Modricës

3. Kalaja e Skudrinës (Dibër)⁵⁴ (x-41°57', y-20°59', z-1180m)

Rrënojat e kalasë së Skudrinës gjenden në faqen lindore të malit të Kërçinit, pranë fshatit Skudrine të Rekës së Poshtme në zonën e Dibrës (Maqedonia e Veriut). Kalaja është ndërtuar në një kreshtë të thiktë shkëmbore të vendosur midis dy përrenjëve të thellë që zbresin nga mali i Kërçinit dhe e kufizojnë atë nga ana veriperëndimore dhe juglindore. Është vizituar më parë nga studiuesë maqedonas, që shënojnë lartësinë e saj absolute 1180m dhe relative 500m⁵⁵. Kalaja gëzon një mbrojtje të shkëlqyer natyrore dhe një pozicion mjaft dominant në kontroll të luginës së Radikës në zonën e Rekës së Poshtme, që lidh pellgun e Dibrës me atë të Pollogut dhe luginën e Vardarit. (fig.24). Kreshta e kalasë mbyllet me një syprinë të sheshtë me formë afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet. Ajo ka gjatësi 55m dhe gjërësi që lëviz nga 29-40m dhe një sipërfaqe rreth 2200m². Në anën jugore dhe atë lindore ajo bie me faqe të thikta shkëmbore me lartësi rreth 500m mbi përroin e gradishtës. Edhe në anën veriore pjerrësia është mjaft e madhe, ndërsa në atë perëndimore, krijon shtegun e vetëm komunikues me një tarracë të përshtatshme për banim, si dhe me terrenin përreth. Kalaja ruan gjurmë të fortifikimit të saj, kronologjikisht të lidhur me tri faza të ndryshme, që i referohen përkatësisht periudhës së Bronzit të Vonë, periudhës së vonë antike⁵⁶ dhe periudhës mesjetare. Periudha e fundit mendojmë se kronologjikisht

⁵⁴ Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar në vizitën e vitit 2009 në këtë kala sipas viteve: Jakup Markja, Dashamir (Dibër), Moisi Murra (Peshkopi), Pëllumb Naipi (Tiranë).

⁵⁵ MIKULČIĆ 1999, 410.

⁵⁶ Muri i periudhës së vonë antike, qarkon anën veriore dhe atë perëndimore dhe me ndërprerje të vogla arrijnë perimetrin 82.5m. Ai ruhet në të gjithë anën veriore, me gjatësi 57m dhe lartësi 0.30-0.50m. Ai është ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur me llaç gëlqerorë të cilësisë së mirë sipas teknikës *opus incertum*. Ai shfrytëzon aftësitë mbrojtëse të terrenit, duke u vendosur mbi shkëmbinjtë natyrorë të terrenit, ndërsa në

lidhet me shek.XIV- XV pas Kr., dhe kryesisht me periudhën e Skënderbeut. Në sistemin fortifikues ajo përfaqësohet nga një kullë rrethore e vendosur në pjesën më të lartë të sipërfaqes së brendshme të kalasë. Kulla me formë rrethore, ka diametër të jashtëm, 7.80m, dhe të brendshëm 3.00m dhe gjërësinë e mureve 2.40m. Muret e kullës janë ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur me llaç gëlqerorë, me trashësinë e fugave 2-2.5cm. Llaçi është bërë me gëlqere të pastazhionuar mirë, të përzier me rërë lumi të situar trashë, dhe cilësisht është i dobët dhe thërmohet nga fërkimi. Në pikpamje të tipologjisë dhe pozicionit topografik, kjo kullë është krejtësisht e ngjashme me atë të kalasë mesjetare të Daules së Kurbinit, si dhe kulla të tilla të fortifikimeve të shek. XIV-XV të Krujës, të Stelushit, të Rodonit, të Durrësit, të Prezës, të Shkodrës⁵⁷, të Petralbës⁵⁸ etj. Kësaj periudhe mendojmë se i përket edhe një sterë uji që gjendet në anën jugperëndimore të kalasë. Ajo ka formë drejtkëndëshe me brinjë 7.00x4.50m dhe thellësi të lexueshme 2.20m. E veçanta e kësaj stere është se në tri anë të saj, përkatësisht në atë lindore, veriore dhe jugore ajo është gdhendur në shkëmb, dhe vetëm faqja perëndimore e saj është zënë nga një mur me gjatësi 4.50m, i ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur me llaç gëlqeror. Faqja e brendshme e këtij muri u gjet e shembur dhe nuk u konstastuan gjurmë të llaçit me pluhur tjegullash, të përdorur zakonisht për hidroizolim të sterave, rolin e të cilit e kanë luajtur sa duket faqet shkëmbore të tri anëve të saj. Kalaja ka shërbyer si fortesë në mbrojtje të rrugës tradicionale Dibër-Pollog-Shkup, që kalonte nëpër luginën e lumit të Radikës.

ndonjë rast edhe duke u mbivendisur mbi murin prehistorik. Muri perëndimor, me gjatësi të përgjithshme 25.5m, në këndin jugperëndimor, tek shtegu i vetëm hyrës, krijon një ndërprerje me gjatësi rreth 4-5 m, që duhet të ketë shërbyer edhe si hyrje e kalasë. Kalaja regjistrohet nga Prokopi i Cezaresë në listen e fortesave të rindërtuara nga Justiniani në mesin e shek. VI pas Kr., me emrin “*Skydreon polis*”. Krhs: Proc. Ceaz. *De Aedificis (Mbi ndërtimet)*, IV, 4, 39). Mendojmë se emri i sotëm *Skudrine* i kalasë dhe i fshatit eponym pranë saj, është trashëguar drejtpërdrejt nga emri *Skydreon* i i kësaj kalaje të periudhës së vonë antike.

⁵⁷ SARAÇI 1987, 207, shën. 16.

⁵⁸ *Vrojtime individuale në terren.*




Fig. 24. Pamje pamje e përgjithshme dhe skica planimetrike e kalasë së Skudrinës (Rekë)

4. Kalaja e fshehtë e Skënderbeut (Dibër) (x-41°75': y-20° 24', z-1205m)

Rrënojat e kalasë së fshehtë të Skënderbeut⁵⁹ gjenden në një kreshtë shkëmbore me lartësi 1205m, në thellësi të luginës së Setës, në faqen juglindore të malit të Xharxhishtit, pjesë e bjeshkës së Pllajut, që lartësohet në perëndim të Çidhnës së Poshtme dhe kanionit të Gjalicave. Ajo ka sipërfaqe të vogël dhe një pozicion zotërues dhe shumë të mbrojtur nga

⁵⁹ Kalaja quhet ndryshe edhe kalaja e “*Sheut të thatë*” (e përroit të thatë). Emri “*Sheu*” ka kuptimin “*përrua*” dhe mbahet si fjalë e vjetër e leksikut të shqipes së kësaj zone. Toponime të tjera të lidhura me këtë kala janë : “*Qafa e kalasë*”, “*Arat e kalasë*”, “*Gurra e Skënderbeut*”, “*Rrafsha e Topit*” etj. Krhs. HOXHA 1979, 236; HOXHA 1989, 571.

natyra, në kontroll të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve dytësore që e lidhnin këtë zonë me Lurën (qytetin mesjetar të Livadhut të Xharrit), kalanë e Stelushit (Qafë-Murrë) dhe atë të Gurit të Bardhë (Petralbës) në Mat (fig. 25). Shtegu i vetëm për të hyrë në kala kalon nëpër qafën e kalasë, në anën jugperëndimore të saj. Në pjesën më të lartë të kalasë ruhen mbetjet e një kulle rrethore. Trakte të shkëputur muresh mesjetare shihen vetëm në anën lindore dhe atë juglindore, në një gjatësi rreth 72m. Ata rethojnë “citadelën” me një sipërfaqe të kufizuar, rreth 500m². Muri është ndërtuar me *opus incertum*, gurë mesatar e të vegjël, të lidhur me llaç të dobët gëlqeror.. Muri arrin trashësinë 1.30-1.50m. Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është konstatuar edhe në kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Shurdhah (1.30-2.60m), në Krujë (0.80-1.50m) dhe Daulë të Krujës (0.75m, 0.90m, 1.10m, dhe 1.80m)⁶⁰, në Stelush dhe në Petralbë të Matit (1.50-1.80m)⁶¹, në Koxhaxhik të Dibrës (1.40-1.70m)⁶² etj. Në anën verilindore të kalasë, ruhet një sterë uji në trajtë katërkëndëshe, me brinjë 1.80 x 2.20m, thellësi të matshme 2.90m dhe vëllim mbi 11.484m³. (fig. 26). Faqet e brendshme të saj kanë qenë të suvatuara me llaç horasan hidroizolues, të përgatitur nga pluhur tjegullash, i cili, edhe pse i shembur, ka lënë gjurmët e tij ngjyrë tulle mbi faqet e murrit. Në sipërfaqen e kësaj kalaje janë gjetur edhe disa fragmente enësh të periudhës mesjetare, kryesisht vorba dhe tasa, me formë dhe dekor të ngjashëm me ato të kalasë së Stelushit, të Koxhaxhikut etj, të lidhura me shek. XIV-XV pas Kr.⁶³. Kjo kala shërbente si pikë vërtetimi dhe lajmërimi me anë sinjalesh dhe si vendstrehim në rast reziku. Mendohet se nëpër Qafën e Xharxhishtit ka kaluar rruga e Skënderbeut që lidhte Lurën me Stelushin. Në shek. XV pas Kr., Çidhna e Poshtme, së bashku me Çidhnën e Epërme (sot Grykë-Nokë) dhe fshatrat Sinjë e Epërme dhe Sinjë e Poshtme, Gurrë, Arras, Shashari i Ruse, në përbërje të Kidhnës⁶⁴ së famshme mesjetare, luajti një rol të rëndësishëm në epopenë skënderbejane kundër superfuqisë otomane⁶⁵.

⁶⁰ SPAHIU-KOMATA 1974, 263; ADHAMI 1971, 87; SARAÇI 1987, 205.

⁶¹ Sipas vërtetimeve të autorit në terren.

⁶² BUNGURI 2009, 31.

⁶³ ANAMALI 1967, 95-112; BUNGURI 2009, 34.

⁶⁴ Në mesjetë kjo krahinë njihej me emrin “*Kidna*” (Krhs. BARLETI 1537 (1964), XIII, 469; INALÇIK 1969, 188). Ky emërtim mendojmë se rrjedh nga onomastika ilire, përkatësisht nga kalaja “*Kithinas*” e shek. VI pas Kr., në qendër të kësaj zone, të cilën Prokopi i Cezaresë, e përfshin në 32 kështjellat e ndërtuara nga Justiniani në provincën *Epirus Nova* (Krhs.Proc. Caes. *De Aedificis*, IV, 29; BUNGURI 2011, 197, 208).

⁶⁵ Në gusht të vitit 1466 populli i saj u përball me masakrën çnjerëzore të sulltan Mehmetit II, i cili, pas dështimit të rrethimit të II të Krujës, gjatë tërheqjes për në Stamboll, kthehet nga Elbasani dhe masakron 8000 burra, gra, pleq e fëmijë, të strehuar në Çidhnën e Poshtme, si hakmarrje kundër Skënderbeut dhe njerëzve të trojeve e gjakut të tij. (Krhs. BARLETI 1537(1964), XII, 469; NOLI 1962, 111).



Fig. 25a. Pamje e përgjiuthshme e kreshtës,



Fig. 25b. Gjurme të murit mesejtar



Fig. 26. Pamje e sterës së ujit

5. Lugina e Bulqizës dhe Vajkali

Lugina e Bulqizës gjeografikisht shtrihet në të gjithë hapësirën nga Qafa e Buallit (844m) në perëndim deri tek Ura e Qytetit (609m) në lindje, në të dy anët e zallit të Bulqizës (lumi "Ebu"), midis malit të Dhoksit në jug dhe atij të Allamanit në veri. Ajo është vendosur në një luginë me origjinë glaciale në formë govate me gjatësi 25km, gjërësi 3-5km dhe lartësi mbidetare 600-800m. Konfiguracioni gjeomorfologjik përcaktohet nga lugina e zallit të Bulqizës (46.5km), me gjurmë të shumta morrenash në anën jugore të saj dhe nga malet kufizuese në jug dhe në veri, të njohura për rezervat e mëdha të kromit. Në këtë luginë shtrihen nga perëndimi në lindje këto qendra banimi: qyteti i Bulqizës, i vjetri dhe i ri dhe fshtarat Duriçaj, Dragu, Koçaj, Vajkal 1 dhe Vajkal 2, Fushë Bulqizë, Dushaj dhe Lepurak, ky i fundit i njohur si lagje e fshatit Dushaj. Lugina e Bulqizës ka pozicion të favorshëm gjeografik dhe frymëmarrje të lirë komunikuese me krahinat fqinje e ato më të largëta. Ajo përshkohet nga korridori më i rëndësishëm natyror që lidh Dibrën me Adriatikut, i njohur si "Rruga e Arbërit". Për funksionimin e këtij korridori rrugor që në

prehistori e sidomos që nga shek. XI para Kr. dëshmojnë gjetjet arkeologjike, që do të përmenden më poshtë, si dhe nga dy përkrenaret prej bronzi të tipit ilir të shek. V-IV para Kr.⁶⁶ dhe enët me vërnik të zi⁶⁷ që i shoqërojnë ata, të gjetura në Sofraçan, në trasenë e “Rrugës së Arbërit” në vitin 2008. Pjesa lindore e kësaj lugine, nga “Gurët e Skënderbeut” në perëndim deri tek Ura e Qytetit (të Valikardhës) në lindje, njihet me emrin Fusha e Vajkalit. Vetëm në skajin lindor të saj, ruhen tre monumente arkeologjiko-historik, kronologjikisht të lidhura me periudhën e vonë antike (qyteza e Valikardhës) dhe atë mesjetare (qyteza e Valikardhës, Kulla e Skënderbeut dhe kisha e Kojzakut). (fig. 27).



Fig. 27-Pamje nga Kulla e Skënderbeut, Qyteza e Valikardhës dhe Kisha e Kojzakut

5a. Qyteza e Valikardhës (x-41° 30' 32", y-20° 18' 53", z-609m)

Emri i kësaj qyteze ka qenë i njohur për kronikat mesjetare, siç dëshmohet nga një dokument i vitit 1464, ku përmendet kampi i Skënderbeut me emrin “Vale Carda”⁶⁸. Është vizituar në vitin 1951 nga prof. H. Ceka e ing. J. Adami, që kanë vënë në dukje se qyteti

⁶⁶ BUNGURI 2010, 261-264, tab.CX, 1-2, CXI, 1-4.

⁶⁷ *Idem*, 265-267, tab. CXIII, 1-6.

⁶⁸ PALL 1965, 202-204 (cituar sipas BIÇOKU 2006, 81, shën.65).

gjendej në anën lindore të luginës së Vajkalit, në një kodrinë të ultë, me mbeturina muresh të lidhura me llaç, përballë Kullës së Skënderbeut⁶⁹. Në vitet e mëvonshme, monumenti është vizituar edhe nga studiuesë të tjerë⁷⁰. Qyteti është vendosur në krahun e djathtë të zallit të Bulqizës dhe Rugës së Arbërit, mbi një kodrinë të ulët shkëmbore me lartësi absolute 609m ngjitur me “Urën e qytetit” (fig. 28).



Fig. 28-pamje veriore dhe e brendshme qytezës së Valikardhës.




Fig. 29a-Trakt i murit perëndimor.

Fig. 29b-Skicë planuimetricke e qytezës së Valikardhës

Ka një pozitë të favorshme strategjike dhe në një farë mase, të mbrojtur në pikëpamje natyrore. Në anën veriore ai bie me faqe krejtësisht shkëmbore mbi zallin e Bulqizës, që e ndan atë nga Shkëmbi i Skënderbeut. Me faqe shkëmbore ai bie edhe në anën perëndimore

⁶⁹ CEKA-ADAMI 1951, 3. “Lugina e Vajkalit në anën lindore ka një kodër të ultë me mbeturina muresh të lidhura me llaç, që quhet “qytet”, ndërsa përballë saj është shkëmbi i pangjithshëm i quajtur “Kulla e Skënderbeut”.

⁷⁰ SADIKU 1971, 222; KACA 2003, 114; KACA 2012, 69; BUNGURI 2014, 297-299.

mbi fushën përreth. Sipërfaqja e qytetit zbret me një pjerësi të zbutur drejt lindjes dhe jugut, ndërsa hyrja e tij, duke gjykuar nga pikëpamja topografike, duhet të ketë qenë në anën juglindore të tij. Sipërfaqja e qytetit ka formë përafërsisht eliptike, me diametrin veriperëndim-juglindje 82.5m dhe atë veri-jug 25m. (fig. 29a) Qyteti ruan gjurmë të sistemit të fortifikues të periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare. Muret e periudhës së parë rrethonin një sipërfaqe rreth 0.2ha dhe ndjekin vijën rrushkulluese të kodrës në trajtë eliptike. Sot mund të flitet vetëm për gjurmë të shkëputura të tij, në anën jugperëndimore, verilindore dhe veriore. Trakti i më mirë i ruajtur i këtij muri, me gjatësi 1.50-1.60m, lartësi 0.80-1.00m, gjendet në anën jugperëndimore, por faqja e jashtme e tij është e dëmtuar. Muri është ndërtuar me gurë mesatarë të terrenit dhe lumorë, të lidhur me llaç gëlqeror, me teknikën *opus incertum*. Llaçi përmban shumë rërë lumi të pasitur, nuk është shumë i fortë dhe nuk ka cilësi të mirë (fig. 29a). Gjurmë të këtij muri shihen edhe në anën verilindore, në hapësirat midis shkëmbinjëve natyrorë. Periudhës mesjetare mendojmë se i takojnë gjurmë të murit rrethues të anës veriore, që mund të ndiqen në një linjë prej 22m, si dhe një kullë rrethore gjurmët e të cilës gjenden në pjesën më të lartë të skajit veriperëndimor të qytezës, kronologjikisht e lidhur me shek. XIV-XV pas Kr. (fig. 29b). Me këtë periudhë lidhen edhe rrënojat e një kisha mesjetare, që ruheshin deri vonë poshtë qytetit, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës⁷¹ si dhe rrënojat e Kishës së Kojzakut⁷², në rrethinën jugore të qytezës së Valikardhës. Qyteza e Valikardhës kontrollonte rrugën kryesore që lidhte Dibrën me Durrësin, të njohur si “Rruga e Arbërit”. Në anën jugore të qytetit gjenden fshati i sotëm Valikardha, që ka trashëguar emrin e qytezës mesjetare *Vale Carda*, ndërsa 2-3 km në perëndim të tij fshati Vajkal, emra këto shumë të njohur për historinë tonë mesjetare. Bashkohemi me mendimin e shprehur më parë se pikërisht këtu duhet lokalizuar qyteza mesjetare e *Geties*, që sipas burimeve historike gjendej pranë rrugës Sfetigrad (Koxhaxhik)-Krujë, emër që më vonë u përvetësua nga fshati **Godvi** pranë kësaj qyteze⁷³. Në mbështetje të këtij lokalizimi vijnë dhe burimet historike të periudhës mesjetare⁷⁴.

⁷¹ SADIKU 1971, 222.

⁷² CEKA-ADAMI 1951, 6.

⁷³ Botuesit e burimeve bizantine janë shprehur për lokalizimin e qytetit të *Geties* në fshatin Godvi të Bulqizës, i cili gjendet pranë rrugës nga kalonin ushtritë turke që shkonin kundër Krujës, e cila gjendet rreth 50km në perëndim të këtij qyteti. Krhs. BOZHORI-LIÇO 1975, shën. 76, 330.

⁷⁴ Sipas L. Halkokondilit ” Murati duke avancuar së pari rrethoi qytetin e Sfetigradit (në origjinal : Sfeti) dhe u propozoi të rrethuarve që ta dorëzonin atë dhe secili prej tyre do të shkonte në shtëpinë e tij. Ata nuk u bindën. Pastaj (Murati) sulmoi me jeniçerët dhe pushtoi qytetin plotësisht dhe e robëroi; të gjithë burrat i vrau. Pastaj duke avancuar mori me marrëveshje **Getien**, dhe mbasi i ktheu në skllëvër ata që gjendeshin brenda në qytet, e drejtoi ushtrinë kundër Krujës”. Krhs. HALKOKONDILI, Lufta e Sfetigradit më 1448, Cituar nga BOZHORI-LIÇO 1975, 330.

5b. Kulla e Skënderbeut⁷⁵ (x-41°30'47'', y-20°18'46'', z-978m).

Kreshta shkëmbore e njohur me emrin " Kulla e Skënderbeut" me lartësi absolute 978m, ngrihet përballë qytezës së Valikardhës, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës (fig. 30a-b).




Fig. 30a- Pamje të shkëmbit të kullës së Skënderbeut; b- Pamje e faqes perëndimore të kreshtës së Kullës së Skënderbeut

Në vitin 1951, H. Ceka-J. Adami kanë shënuar se “Kulla e Skënderbeut” gjendet në një shkëmb të pangjithshëm përballë “qytetit” të Valikardhës⁷⁶. Ajo ka një pozitë shumë të mbrojtur natyrore, me kontroll të plotë mbi Fushën e Vajkalit, gjithë luginën e Bulqizës dhe “Rrugën e Arbërit”, që kalonte poshtë saj. Platforma e kësaj kreshte me planimetri poligonale, diametrat lindje-perëndim dhe veri-jug 16x65m, dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme rreth 1000m², ka një pjerrësi të lehtë jugore. Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut ka rrënje të thikta shkëmbore në tre anë, atë jugore, perëndimore dhe lindore, ndërsa në anën veriore, ndahet nga pjesa veriore më e lartësuar e saj, nga një kanion shkëmbor me thellësi 3.50-4.00m dhe gjërësi 10-12m. Më në veri të saj lartësohet “Maja e Tëmblave” nën të cilën gjendet “Çardaku” (i Skënderbeut), një shesh i vogël, me hapësirë shikimi mjaft të madhe. Kreshta ku gjendet “Kulla e Skënderbeut” ka një pozitë mjaft dominante. Prej aty kontrollohet lehtësisht e gjithë lugina e Bulqizës, nga Qafa e Buallit në

⁷⁵ Falenderoj miqtë dhe bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar në dy vizitat e realizuara në këtë monument: (gusht 2018): Gazmend Sejdi (Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Sh. Tançi" Bulqizë), Sami Curri dhe Geri Emiri (gazetarë), Lulzim Hupi (pronar i bujtinës "Hupi"), dhe Ervin Kujtila (arkeolog); (shtator 2018): Gazmend Sejdi (Drejtor i Shkollës 9 vjeçare "Sh. Tançi" Bulqizë), dy nxënësit e Shkollës së Mesme Bulqizë, Renis Isufi dhe Bleon Zogu si dhe Dr. Elio Hobdari-arkeolog (IA-Tiranë).

⁷⁶ CEKA-ADAMI 1951, 3.

perëndim (844m) deri në luginën e Drinit të Zi dhe qytetin e Dibrës në lindje. Komunikimi vizual është i dukshëm jo vetëm me qytezën e Valikardhës tek “Ura e Qytetit” dhe “Fushën e Vajkalit” që hapet pranë saj, por edhe me qytezat e Krajkës dhe të Sofraçanit, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës dhe Fushën e Gurrës (Strikçan) në krahun e djathtë të luginës së këtij lumi. Ngjitja në “Kullën e Skënderbeut” fillon nga fshati Lepurak i Vajkalit, prej ku duhet të ecësh në një monopat të pjerrët për rreth 1.5-2 orë, deri tek “Rruga e fshehtë e Skënderbeut”, rreth 200m nën platformën e kreshtës shkëmbore ku gjendet kulla. Kjo rrugë e fshehtë me gjatësi 50-60m dhe gjërësi 2.00-2.50m, ka pjerrësi të fortë, rreth 30-35°. Ajo fillon nga “Guri i dybegut” dhe arrin deri tek faja perëndimore e kreshtës. Rruga e fshehtë ka qenë hapur në shkëmb dhe është e shtruar me rasa guri (fig. 31a).



Fig. 31a. Pamje e rrugës së fshehtë të Kullës së Skënderbeut; 31b. Gur dybeku

Guri i dybegut gjendet rreth 200m nën faqen perëndimore të kullës, në një sheshpushim buzë "Rrugës së fshehtë të Skënderbeut". Është fjala për një shkëmb natyror me faqe të sheshtë, me përmasa 2.20x1.10x0.70m, në pjesën qendrore të së cilës, është gdhendur një gropë cilindrike me diametër 23x23cm, thellësi 5.6cm dhe faqe të lëmuara. Është identik me dy gurët e dybekut të kalasë së Koxhaxhikut dhe mendohet se ka shërbyer për shtypjen e barutit (fig. 31b). Kreshta shkëmbore e njohur me emrin " Kulla e Skënderbeut" ka sipërfaqe afërsisht poligonale (fig. 32a-b).



Fig. 32a-Pamje e Kullës së Skënderbeut; 32b.Skicë planimetrike e Kullës së Skënderbeut

Gjatë surveit të gushtit 2018, u konstatuan dy struktura ndërtimore, si pjesë integrale e monumentit mesjetar:

a. Kullë vrojtimi. Në pjesën më të lartë dhe të skajshme veriore të Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut, gjenden rrënojat e një kulle mbrojtëse. Kulla ka formë drejtkëndëshe me ball të harkuar, që i është përshtatur formës së terrenit dhe përfshihet në tipin e kullave në trajtë "U"-je ose në trajtë patkoi. Kulla ka orientim verior, gjatësi 5.50m dhe gjërësi 6.70m. (fig. 33a-b). Muret e ndërtuara me gur të lidhur me llaç gëlqeror, ruhen në gjendje rrënoje, me gjërësi të lexueshme 0.40m. Në anën lindore të kullës, ruhet një trakt muri me gjatësi 2.00m dhe gjërësi 0.40m, që i vishet nga ana e jashtme faqes së shkëmbit natyror, i cili më parë është prerë vertikalisht (fig. 33c). Në gjatësinë 5.50m, faqja jugore e kullës mbyllet me anë të një muri tërthor lindje-perëndim. Gjurmë të murit lindor të këtij fortifikimi, në trajtë rrënojash, vazhdojnë drejt jugut, dhe ndiqen deri në gjatësinë 10m. Në anën perëndimore të kreshtës, gjurmë në trajtë rrënoje të këtij muri mbrojtës, mund të ndiqen deri në gjatësinë 16m, tek shtegu hyrës i kreshtës së Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut. Gjurmët e ruajtura në trajtë rrënoje të murreve mbrojtëse, tregojnë se fortifikimi ka qenë i pjesshëm dhe ka shfrytëzuar mjaft mirë vetitë mbrojtëse të terrenit. Kjo situatë arkitektonike, na shtyn të besojmë se thelbi i këtij fortifikimi përfaqësohet nga një kullë në trajtë "U"-je ose patkoi, ku mund të strehoheshin një grup i vogël ushtarësh, me detyra kryesisht të karakterit vrojtues dhe sinjalizues. (watching tower). Kulla në trajtë U-je, ose gjysëmrrethore janë një tip planimetrik i zakonshëm në fortifikimet mesjetare, përfshirë edhe ato të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Tipi i kullës gjysëmrrethore

ndeshet në kalanë e Petralbës⁷⁷, të Petrelës⁷⁸, të Krujës⁷⁹, në kështjellën e poshtme të kalasë së Durrësit⁸⁰, ndërsa kullat në trajtë U-je mbrojnë hyrjen e qytetit të sipërm të kalasë së Shurdhahut (Sarda)⁸¹ etj.



Fig. 33a-b-Pamje e murrit verior dhe lindor të kullës së Skënderbeut

⁷⁷ Shikuar në terren nga autori.

⁷⁸ KARAISKAJ 2016, 118, fig. 128.

⁷⁹ *Idem*, 141, fig. 157.

⁸⁰ *Idem*, 161, fig. 185.

⁸¹ *Idem*, 129, fig. 140.




Fig. 33c-Skicë planimetrike e murrit verior të kullës së Skënderbeut

b. Sterë uji. Në gjysmën jugore të kreshtës shkëmbore, ruhen gjurmët e një stere të nëndheshme uji, të ndërtuar me murre guri të lidhur me llaç gëlqeror. Stera ka qenë e mbuluar me qemer cilindrik gjatësor, sot i shkatërruar thajse tërësisht nga thesarkërkuesë klandestin. Është fjala për një strukturë me planimetri drejtkëndëshe, me orientim verior, me 5° shmangje lindore nga aksi i veriut. Përmasat e brendshme të saj janë $3.97 \times 3.47 \times 2.50\text{m}$ ($4.00 \times 3.50 \times 2.50\text{m}$). Vëllimi i përafërt i sterës është 35m^3 , me një kapacitet ujëmbajtës 35.000 litra (*fig. 34a-b*).



Fig. 34a-Pamje e përgjithshme e sterës




Fig. 34b Plan & prerje e sterës

Hapësira e brendshme e sterës ka qenë e suvatur me horasan të përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i papërshkueshëm nga uji. Mbetje të këtij llaçi me sipërfaqe mirë të lustruar dhen ngjyrë okër në të kuqërremtë, sot ruhen vetëm në dyshtemenë

dhe pjesët fundore të sterës, përkatësisht në murin jugor dhe lindor të saj, ndërsa në pjesët e sipërme të mureve, edhe pse ka rënë, ky llaç ka lënë në faqet e gurëve, ngjyrën okër të hapur të tij, lehtësisht e lexueshme. Dyshemeja e sterës ka qenë e shtruar me llaç harasan i përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i njëjtë me atë të faqes së brendshme të mureve anësorë, shtresa e të cilit është mjaft e ngjeshur dhe e fortë. Në pjesët fundore të sterës, ruhet edhe shtresa e llaçit hidroizolues me trashësi 2.5-3cm dhe ngjyrë okër në të kuqërremtë, që ka veshur faqet e brendshme të murreve anësor të saj (fig. 34c).



34c- Detaje të llaçit hidroizolues të sterës

Gjërësia e murreve anësor të sterës është 0.60m, ndërsa gjërësia e murit jugor të saj është 2.00m. Ky murr i jashtëm jugor mund të ketë shërbyer si përforcues i strukturës së sterës ose si aksesori i largimit të ujrave të tepërta. Muret e sterës janë të ndërtuara me gurë gëlqerorë të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, me shumë gëlqere dhe pak rërë lumi. Ndërsa muret jugor dhe verior kanë faqe vertikale, muret lindor dhe perëndimor harkohen lehtë për të formuar qemerin cilindrik ose gjysëmrrrethor. Harkimi fillon në kuotën 0.98m (1.00m) mbi nivelin e dyshemesë. Lartësia e ruajtur e qemerit në anën lindore është 1.00m dhe në atë perëndimore 0.45m, ndërsa shigjeta e harkut të qemerit rezulton të ketë qenë 1.40m. E gjithë hapësira e brendshme e strukturës, është e mbushur me gurë gëlqerorë të murreve si dhe me gurë çmërsi ranorë të qemerit. Këto të fundit janë të gdhendur, me faqe të sheshta dhe mjaft të lehtë në peshë, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre në kupolën e qemerit. Gurë të të dy llojeve gjenden edhe në anën perëndimore dhe veriore të kësaj strukture. Sterat e ujit kanë qenë pjesë organike e nevojshme dhe e domosdoshme e

fortifikimeve mesjetare në përgjithësi, përfshirë edhe fortifikimet e ndërtuara në kohën e Skënderbeut. Duke e ditur se nevojat e domosdoshme fiziologjike për një njeri janë 2 litra në ditë⁸², mund të llogaritet se stera e Kullës së Skënderbeut, me një kapacitet ujëmbajtës prej 35.000 litrash, mund të plotësonte nevojat e një grupi prej 50-60 ushtarësh për 30 ditë, edhe po të mos binte asnjë pikë shi. Në pikëpamje planimetrike dhe tipologjike, stera e Kullës së Skënderbeut është e ngjashme me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit⁸³, me atë të Modriçit⁸⁴, atë të kalasë së Skudrinës⁸⁵ në luginën e poshtme të Radikës (Dibër), me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut⁸⁶, në Çidhën të Poshtme, me sterën e vogël me qemer gurësh çmërsi në qytetin e Stelushit (Mat)⁸⁷, me sterën nr. 1 me qemer cilindrik të kalasë së Shkodrës⁸⁸ (e ndërtuar para rrethimit të parë të Shkodrës)⁸⁹, me sterën me qemer cilindrik të kështjellës së Matricës⁹⁰ në Rubik etj. Të dy strukturat e mësipërme të këtij monumenti, kulla në formë patkoi dhe stera e ujit, në pikëpamje kronologjike, lidhen ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Përveç tipareve teknike dhe analogjive të tyre të cekura më lart, mund të përmendim edhe dy objekte mesjetare të lidhura me Kullën e Skënderbeut, përkatësisht një gur dybeku (fig. 31b) dhe një mokër bloje (fig. 37c).

⁸² KARAISKAJ 1985, 66.

⁸³ SARAÇI 1987, 210.

⁸⁴ BUNGURI 2009, 47, fig. 32.

⁸⁵ BUNGURI 2014, 297, fig. 8.

⁸⁶ BUNGURI 2011, 215, fig. 11.

⁸⁷ ANAMALI 1967, 106.

⁸⁸ KARAISKAJ 1985, 60-61, 66-67, tab. I.

⁸⁹ *Idem*, 67.

⁹⁰ HOXHA 2016, 163, fig. 8b.



Grupi i punës në majën e "kullës së Skënderbeut"

Në mbyllje duhet të vemë dukje një veçori të fortifikimeve të ndërtuara apo rindërtuara në kohën e Skënderbeut. Është fjala për ngjashmërinë e fortë të skemës topografike dhe planimetrike e kalasë së Koxhaxhikut me kala të tjera të pranuar mirëfilli

si të rifortifikuara apo të ndërtuara nga Skënderbeu, siç janë kalaja e Stelushit (Qafë-Murrë), kalaja e Petralbës (Mat), kalaja e Krujës, kalaja e Daules (Kurbini), kalaja e Petrelës (Tiranë)⁹¹ etj.

Është e tepërt të themi se të gjitha kalatë e mësipërme të Skënderbeut gjenden në rajone malore, në mbrojtje të rrugëve të brendshme strategjike nga lëviznin ushtritë. Pjesa kryesore e këtyre kalave, disa prej të cilëve ishin njëherësh edhe qytete mesjetarë, përbëhej nga zona e fortifikuar ose „citadela“, që gjendet në majën e kodrës dhe luan rolin e “akropolit” dhe „varoshi“ ose qyteti jashtë mureve rrethuese, ku gjenden godinat e banimit dhe ato shoqërore dhe zejtare. Çitadela kishte përmasa modeste, me madhësi nga 0.1-0.2ha. Si element integral ajo kishte gjithnjë pusin apo sterën e ujit, zakonisht të furnizuar me tubacion qyngjesh qeramike nga burime të jashtme, dhe në ndonjë rast edhe me ujët e shiut. Përmasat e vogla të çitadelës janë në përputhje me artin ushtarak të Skënderbeut, i cili kurrë nuk i përqëndronte të gjithë forcat brenda saj. Aty ai linte një garnizon të vogël, ndërsa me forcat kryesore i ngrinte pusi armikut, duke e goditur atë në befasi, natën, në fushim ose gjatë marshimit, dhe duke e asgjësuar atë pjesë pjesë. Për ilustrim, po sjellim një tabelë mbi lartësitë mbidetare të disa prej kalave të Skënderbeut në rajonin e Dibrës, Matit dhe Krujës:

Nr.	Kalaja ose fortifikimi	Rajoni	Lartësia absolute (m)
1.	Qytei i Stelushit	Qafë-Murrë/Dibër-Mat	1225
2	Kalaja e Çidhnës së Poshtme	Çidhën/Dibër	1205
3.	" Koxhaxhikut	Zhupë/Dibër	1160
4.	" Modricës	Gollobordë/Dibër	996
5	" Skudrinës	Rekë/Dibër	1180
6.	Kulla e Skënderbeut	Vajkal/Bulqizë	978
7.	Kalaja e Petralbës (Gurit të Bardhë)	Gur i Bardhë/Klos	878
8.	e Krujës	Krujë/Krujë	610
9.	" Daules	Kurbini/Krujë	527

⁹¹ ANAMALI 1967, 108 ; SARAÇI 1987, 205-206.

10.	" Petrelës	Tiranë/Tiranë	329
-----	------------	---------------	-----

5c. Kisha e Kojzakut (x-41° 29' 49"; y-20° 18' 32"; z- 843m)

Kisha e Kojzakut, e njohur edhe si “Kisha e Kodrës së Gjelit”, gjendet në majën e një kodrine konike, rreth 1 km në jug të qytezës së Valikardhës (fig. 35a). E ngritur midis përroit të Valikardhës në lindje dhe rrugës që lidhte Valikardhën me Tërnovën në perëndim, kodrina ka pozitë dominante dhe kontrollon një hapësirë mjaft të gjërë. Kodra është e veshur me vegjetacion të dendur dushku dhe shkurresh të tjera. Në syprinën e saj gjenden rrënoja muresh të lidhura me llaç gëlqeror, që populli i quan “kishë”. Monumenti është vizituar për herë të parë nga studiuesit H. Ceka-J. Adami⁹². Gjatë vizitës sonë, konstatuam se është fjala për një rrënojat e një kishë mesjetare njënefshe me përmasa të vogla, për fat të keq të shkatërruar nga thesarkërkuesit klandestin. Në rrënojat e saj u gjetën disa fragmente të suvasë polikrome që kanë zbukuruar faqet e brendshme të naosit. Fragmentet e mbetura të suvasë, ruajnë motive gjeometrike brezash linear të pikturuar me ngjyrë të kuqe tulle, gri të errët dhe të bardhë (fig.35b). Për pozitën e saj dominante, nuk përjashtohet mundësia që gjatë periudhës otomane, pas islamizimit, kisha mund të jetë kthyer në ndonjë karakoll ushtarak në kontroll të rrugës së shkurtër Dibër-Tiranë, në linjën Valikardhë-Tërnovë-Martanesh-Bizë-Shëngjergj-Tiranë.



⁹² CEKA-ADAMI 1951, 6.

Fig. 35a. Pamje e kishës së Kojzakut

Fig. 35b. Suva polikrome të kishës së Kojzakut

6. Objekte arkeologjike:

Sipas të dhënave arkeologjike, gjurmët më të hershme të banimit të luginës së Bulqizës i takojnë shek. XII-IX para Kr. dhe topografikisht lidhen me territorin e fshatit Vajkal (x-41°31'9'', y-20°17'13'', z-750-800m). Përveç tyre, në afërsi të Vajkalit janë gjetur edhe objekte të tjera, që dokumentojnë banimin e kësaj zone, në periudhat e mëposhtme prehistorike dhe historike:

a. Periudha e tranzicionit nga Bronzi i Vonë në Hekurin e Hershëm (shek. XII-IX para Kr.) Kësaj periudhe i përketin dy objekte prehistorike, të gjetura pranë kodrinës “Suka e Lepurit” të fshatit Vajkal, përkatësisht një majë heshte bronzit dhe një kantar pseudominoen, që përfaqësojnë inventarin e një varri të shkatërruar ilir të periudhës submikene (1125-1050 para Kr.) ose protogjeometrike (1050-900 para Kr.).

a1. Majë heshte bronzit. Gjetur në fshatin Vajkal. Ruhet në Muzeun Historik të Peshkopisë (më tej: MHP), nr.inv.1472, fig. 36a, 1. Është e tipit fletë ngushtë në trajtën e gjethes së shelgut, me bisht tubiform me prerje rrethore. E gjithë fleta përshkohet nga një kurriz konik gypor, gjithashtu me prerje rrethore. Supet i ka të rrumbullakuara, ndërsa bishti gypor fare afër fletës, përshkohet horizontalisht nga dy vrima përçinash. Gajtësia e përgjithshme 20.5cm, gjatësia e fletës 10cm, gjërësia maksimale e fletës 2.4cm. Është një variant i majës së heshtës së tipit me fletë në trajtë gjethi. Është e ngjashme me heshta analoge të tumës IV të Pazhokut⁹³ etj. Datimi më i mundshëm: periudha submikene (1125-1050 para Kr.) ose protogjeometrike (1050-900 para Kr.)⁹⁴.

a2. Dyvegjake ilire e restauruar. Gjetur në fshatin Vajkal (Bulqizë). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 36a, 2. Lartësi 9cm, diametri i grykës 6cm dhe i trupit 11cm. Ka trup dykonik të theksuar, qafë të shkurtër, buzë të drejta dhe fund konkav. Vegjët vertikale me prerje eliptike, që lartësohen mbi grykë, i ngjiten enës në zonën e shpatullave, mbi vijën shumë të theksuar të karrinimit. Është punuar me brum argjilor të pastruar, me pak grimca kuarci, me pjekje dhe lëvim të mirë. Mungesa e zbukurimit dhe dykoniciteti i theksuar, i japin enës së Vajkalit, veçori lokale në raport me enët analoge të kulturës ilire të kësaj

⁹³ BODINAKU 1982, 79, tab.V,3.

⁹⁴ BUNGURI 1989, 67-69, tab. I, 1; BUNGURI 2010, 253, tab. CIII, 1.

periudhe. Datohet në periudhën submikene ose protogeometrike, nga shoqërimi i saj me majën e heshtës të përshkruar më lart⁹⁵.



Fig. 36a1-2. Vajkal: Heshtë bronzi dhe dyvegjake ilire

b. Periudha e zhvilluar e epokës së Hekurit (shek. VIII-VII para Kr.)

b1. Majë heshte hekuri me fletë në trajtë gjethi. Është gjetur në Qafën e Buallit, në skajin perëndimor të luginës së Bulqizës (x-41°28'54", y-20° 11' 43", z-844m). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 36b. Gjatësia e përgjithshme është 19cm, gjatësia e fletës 11.5cm dhe gjatësia e tunit 7.5cm. Përfshihet në tipin e heshtave me fletë në trajtë gjethe plepi, me gjërësi max. 4.2cm, të përshkruar nga kurrizi gjatësor me prerje rombike, tun tubiform me prerje rrethore dhe diametër max. 2cm. Në anën e jashtme, përkatësisht në 1/3 e gjatësisë së tij, tuni është i hapur. Raporti i gjatësisë së tunit me gjatësinë e përgjithshme të heshtës

⁹⁵ BUNGURI 2010, 253, tab. CIII, 2.

është 1:2.5. Datohet në periudhën e zhvilluar të epokës së Hekurit, shek. VIII-VII para Kr.⁹⁶.




Fig. 36b. Majë heshte hekuri (Qafë Buall); 36c. Maja shigjetash mesjetare (Vajkal)

c. Periudha mesjetare paraosmane dhe periudha e Skënderbeut (shek. XIV-XV pas Kr).

c1. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 44, fig. 36c, 1. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 8.5cm, gjatësia e fletës 4cm, gjërësia e fletës 2cm, gjatësia e bishtit konik 4.2cm, diametri i bishtit 0.6-0.8cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, me veshëza të zhvilluar, me bisht konik gypor. Fleta me prerje trekëndëshe, përshkohet nga një kurriz gjatësor me prerje ovale në të gjithë gjatësinë e saj.

⁹⁶ BUNGURI 2010, 256, tab. CVI, 12.

c2. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 45, fig. 36c, 2. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 7.2cm, gjatësia e fletës 3.2cm, gjërësia e fletës 1.7cm, gjatësia e bishtit konik 3.6cm, diametri i bishtit-0.8-1cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, pa veshëza, me bisht konik gypor. Në dallim nga maja e shtizës nr. 1, ka fletë me prerje trekëndëshe të shtrirë dhe kurriz shumë të lehtë gjatësor. Maja shigjetash me forma të ngjashme njihen në periudhën e hershme mesjetare, të zbuluara në varrezat e kulturës arbërore të Krujës⁹⁷, Lezhës⁹⁸, kalasë së Dalmaces⁹⁹, kështjellës së Pogradecit¹⁰⁰ etj, dhe vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XIV-XV pas Kr.

c3. Valikardhë (x-41° 30' 24"; y-20° 19' 8", z-625m). Enë e tipit ojnohe. Zbuluar nga punimet bujqësore në fshatin Valikardhë të Zerqanit (Bulqizë) (x-41° 30'24"; y-20° 19' 8", z-625m). Ruhet në Muzeun Arkeologjik, Tiranë, nr. inv. 16478. Përmasat: lartësi 13.5cm, diametri i trupit-9cm, diametri i fundit 7cm, pesha 290gr., fig. 37a. Ena ka grykë trifletëshe me diametër 5.5cm, lëfyt të holluar në majë, trup të fryrë sferik, që veçohet nga gryka me një profilim të lehtë, fund të sheshtë dhe vegjë biforata të thyer. Është punuar me brum të pastër argjilor me ngjyrë rozë dhe ka pjekje shumë të mirë. Ajo është lyer me angobë të hollë të kuqëremtë në rozë dhe është zbukuruar me glazurë polikrome të tipit "*maiolica arcaica*"¹⁰¹. Zona e zbukuruar përfshin të gjithë trupin e enës, nga fundi deri në buzë. Motivet me karakter gjeometrik përfaqësohen nga dy shirita në formë të germës"U", të alternuar me shirita të valëzuar vertikal midis tyre, të gjitha këto të realizuara me pastë të gjelbër. Fusha e shiritave në formë U-je, është e mbushur me pastë të bardhë, e cila nga pjekja në disa vende ka fituar qelqëzim me ngjyrë portokalli. Është enë e kushtueshme importi, e sjellë ose nga brigjet italice, ku enë të tilla gjenden në Pulia, Bari, Venecia etj, dhe datohen në vitet 1350-1450 pas Kr.¹⁰². Gjetja e saj në afërsi të qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj. Enë të ngjashme, të zbukuruara me "*sgraffito polychrome*" vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XV dhe në fillim të shek. XVI pas Kr., kur shënojnë një përhapje mjaft të gjërë në gjithë Egjeun dhe Mesdheun Lindor¹⁰³. Gjetja e saj pranë qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj.

⁹⁷ ANAMALI-SPAHIU 1979-1980, 57, tab. IV, 7.

⁹⁸ PRENDI 1979-1980, 131, tab. XVII; 1-3.

⁹⁹ SPAHIU 1964, 82.

¹⁰⁰ ANAMALI 1979-1980, 231, tab. XI, 5.

¹⁰¹ CRESCENZO 1992, 38-49.

¹⁰² *Idem*.

¹⁰³ VROOM 2005, 143, tab. 2.3.

c4. Mokër bloje, e fragmentuar. Gjetur gjatë surveit të vitit 2018, në sipërfaqen e kreshtës së “Kullës së Skënderbeut”. Përmasat: diametër 52cm, trashësi 6cm dhe diametri i vrimës së aksit-5cm (fig. 37b). Mokra të tilla bloje janë të zakonshme në vendbanimet mesjetare kudo në Shqipëri dhe më gjërë.



Fig. 37a-Ojnohe (Valikardhë)

Fig. 37b-Gurë mokre (Kulla e Skënderbeut)

7. Edhe njëherë mbi lokalizimin e Vajkalit

Në fushën e Vajkalit brenda 5 muajve të vitit 1465 janë zhvilluar dy beteja të përgjakshme midis ushtrisë shqiptare të drejtuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe ushtrive osmane. Në betejën e parë (prill 1465), Sulltani Mehmeti II, dërgoi kundër Skënderbeut një ushtri prej 15.000 kalorësish dhe 3000 këmbësorësh, nën komandën e Ballaban Pashës (Baderës)¹⁰⁴, ndërsa ushtria e Skënderbeut përbëhej vetëm nga 4.000 kalorës dhe 1.500 këmbësorë¹⁰⁵. Sipas Barletit Skënderbeu *“kishte zgjedhur gjithë veteranët dhe lulen e rinisë, në trimërinë e të cilëve kishte shumë besim”*¹⁰⁶. Po sipas Barletit, *“Kampi i skënderbegasvet ishte në një luginë të këndshme dhe të hapët, që zgjatej përpara dhe që e kish emrin Valkali”*¹⁰⁷, ndërsa ushtria osmane i *“kishte ngritur çadrat nga ana tjetër e luginës, pranë një mali, i cili i jepte fund Valkalisë dhe nëpër të cilin kalohej përmes grykash e ngushticash.”*¹⁰⁸. Beteja ishte e ashpër dhe e përgjakshme. Ajo u fitua prej Skënderbeut, edhe pse me humbje të mëdha në forca njerëzore. Përveç qindra ushtarëve, nga kampi i Skënderbut ranë në fushën e betejës edhe komandnti i përgjithshëm i ushtrisë, Moisi Golemi ose *“Moisiu i Dibrës, më i dashuri dhe më besniku për Skënderbenë”*, dhe 7 komandantë të tjerë të shquar, gjegjësisht *“Gjuric Vladeni (Vladan Gjurica), që kishte lidhje gjaku me Skënderbeun, Muzaka i Angjelinës (Muzakë Arianiti), nip prej motre i Skënderbeut, Gjini Muzaka, Gjoni Perlati, Nikollë Berisha, Gjergj Kuka dhe Gjini Maneshi,*

¹⁰⁴ BARLETI (1537), 1964, XI, 449.

¹⁰⁵ *Idem*, 449.

¹⁰⁶ *Idem*, 449.

¹⁰⁷ *Idem*, 450.

¹⁰⁸ *Idem*, 450.

të cilët me vdekjen e tyre e bënë Arbërinë më të përlotur se ndonjëherë më parë”¹⁰⁹. Në betejën e dytë të Vajkalit të gushtit 1465, ushtria osmane kishte 20.000 kalorës dhe 4.000 këmbësorë dhe ajo e Skënderbeut 8.000 kalorës dhe 4.000 këmbësorë¹¹⁰. Disa nga komandantët e kohortave të ushtrisë së Skënderbeut, në këtë luftë ishin: Tanush Topia, Zaharia Gropa, Pejko Manuelli etj. Po sjellim disa rreshta të Barletit mbi këtë betejë: “Ndërmjet Skënderbeut dhe Ballabanit ia nisi një përleshje shumë e madhe. Kërdia e burrave nga të dy palët po bëhej e pazakonshme.Më në fund, kur e pa se fitorja ishte padyshim e epirotëve (shqiptarëve) dhe se nuk mund t’i bënte ballë betejës, ai (Ballabani) i dha kalit dhe ia mbathi sa munda më shpejt dhe gjithë ushtria, gjithë rradhët, të përziera dhe të ngatëruara, muarrë arratinë, duke u shpërndarë sa andej këndej nëpër luginë, nëpër fushë e nëpër male. Të paktë qenë ata që.....mundën të dilnin gjallë....gjithë barbarët (turqit) e tjerë ose u vranë, ose u zunë të gjallë”¹¹¹. Kjo betejë përfundoi me fitoren e ushtrisë shqiptare dhe shpartallimin e turqëve dhe të renegatit B. Pasha (Badera) dhe rikonfirmoi pathyeshmërinë e Skënderbeut dhe vazhdimin e qëndresës antiosmane të shqiptarëve.



Fig. 38. Pamje nga fusha e Vajkalit (Bulqizë)

¹⁰⁹ *Idem*, 451.

¹¹⁰ *Idem*, 458-459.

¹¹¹ *Idem*, 462.

Lokalizimin e Vajkalit, e ka bërë vetë M. Barleti, kur shkruan mbi betejën e parë të Vajkalit, midis Skënderbeut dhe renegatit B. Pasha (Badera): “*Kampi i skënderbegasvet ishte në një luginë të këndshme dhe të hapët, që zgjatej përpara dhe që e kish emrin Valkali*” ndërsa ushtria osmane i “*kishte ngritur çadrat nga ana tjetër e luginës, pranë një mali, i cili i jepte fund Valkalisë dhe nëpër të cilin kalohej përmes grykash e ngushticash.*”¹¹² (fig. 38). Në kohën tonë ky lokalizim është mbështetur nga H. Ceka-J. Adami¹¹³ dhe në pikëpamje gjuhësore është argumentuar nga E. Çabej, që ka shënuar se “*forma më e vjetër e tij duhet të ketë qenë Valkal, Valchalia (te Marin Barleti (1537), emri i një luginë në krahinë të Dibrës, që përbën rrugë kalimi*”, emër si “*luginë, udhë, rrugë kalimi*”, që mund të ketë ardhur prej latinishtes “*vall(is) callis* “*luginë, rrugë*”¹¹⁴. Ndërkaq, O. Schmitt e vendos atë në fshatin Valikardhë, fqinjë lindor i Vajkalit¹¹⁵. Një pikëpamje krejt të ndryshme ka shfaqur K. Biçoku, që mendon se Vajkali duhet vendosur diku në lindje të Ohrit, hipotezë e pasqyruar edhe në Historinë e Shqipërisë të vitit 2002¹¹⁶. Sipas tij, emri *Valkal-Vajkal* rrjedh nga bashkimi i emrave “*val*” dhe “*kal*” dhe do të thotë “*luginë e kuajve*”, toponim që u dashka lokalizuar diku në lindje të Ohrit, ku “*kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët*”¹¹⁷(!), mendim i përsëritur edhe në një botim të kohëve të fundit¹¹⁸. Argument i pakundërshtueshëm i lokalizimit të betejës së Vajkalit në Vajkal, është pa dyshim vetë fshati Vajkal dhe Fusha e Vajkalit, si dhe përputhja e plotë e tyre me

¹¹² BARLETI (1537), 1964, XI, 450.

¹¹³ CEKA- ADAMI 1951, 3: “*Valchalia. I përgjigjet plotësisht Vajkalit. Ngushtica në njerën anë ka një kodër të ultë me mbeturina muresh me llaç, që quhet “qytet”, dhe në anën tjetër shkëmbin e pangjtitshëm “Kulla e Skënderbeut”.*”

¹¹⁴ ÇABEJ 2008, 587.

¹¹⁵ SCHMITT 2014, 171.

¹¹⁶ BIÇOKU 2002, 449-450. Paraqitja e pikëpamjes individuale dhe subjektive të një studiuesi, si mendim zyrtar dhe i institucionalizuar i historiografisë shqiptare, është sipas pikëpamjes tonë, i gabuar dhe jo në përputhje me kriteret shkencore të botimeve institucionale. Në një botim zyrtar, kërkohet më së paku, të paraqiten dy hipotezat e ndryshme mbi lokalizimin një vendbeteje apo lokacioni historik, dhe jo të paraqitet si e mirëqenë vetëm njera prej tyre dhe të injorohet mendimi i kundërt, siç ka ndodhur në këtë rast, aq më tepër, kur alternativa e dytë është, sipas bindjes sonë, krejtësisht e vërtetë.

¹¹⁷ Për më tepër po citojmë autorin e kësaj hipoteze: “*Kur përshkruan Valkalin, M. Barleci tregon se ishte luginë pranë malit Bigë (Furkë), emër mali e vargmali ky në lindje të qytetit të Ohrit.... Vetë M. Barleci ka treguar se Valkali ishte luginë, prandaj ai toponim i latinizuar është i përbërë nga dy fjalë (Val dhe Kal), prej të cilëve, e para me siguri shqipërohet “luginë” dhe e dyta lidhet me “kalë”. Të dyja së bashku zbërthehen në shqip “Lugina e Kuajve”. Ky emër dëshmon se në këtë luginë kuajt e ushtrive çlodheshin dhe se aty kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët*”. Krhs. BIÇOKU 2006a, 81-82; BIÇOKU 2006b, 82.

¹¹⁸ BIÇOKU 2016, 163.

Vajkalin e përshkruar nga M. Barleti. “Kulla e Skënderbeut” e ndërtuar mbi luginën e Vajkalit, në kontroll dhe mbrojtje të luginës së Vajkalit dhe të “Rrugës së Arbërit” që kalonte përmes saj, është padyshim një argument i ri që e përforcon identifikimin e Vajkalit në Vajkal. Në të mirë të këtij identifikimi flasin gjithashtu edhe një varg toponimesh nga gjeografia historike, si “Vajkal”, “Fusha e Vajkalit”, “Valikardhë”, “Fusha e kalasë” (Valikardhës), “Shkëmbi i kullës së Skënderbeut”, “Kulla e Skënderbeut”, “Çardaku i Skënderbeut”, “Liqeni i Skënderbeut”, “Përroi i Skënderbeut”, “Gurra e Kuqe”, “Gurët e Skënderbeut”¹¹⁹ etj. Fortifikimet mesjetare dhe të dhënat arkeologjike të paraqitura më lart, dëshmojnë se gjatë epopesë Skënderbejane, rritet ndjeshëm numri i vendbanimeve dhe fortifikimeve ushtarake, dukuri që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, Dibra, shëndrohet në këtë periudhë në një rajon strategjik të luftimeve çlirimtare të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Kërkimet e ardhshme arkeologjike, do të sjellin, pa dyshim, të dhëna më të plota mbi fortifikimet e periudhës së Skënderbeut edhe në rajonin e Dibrës.



Fig. 39. Monumenti i Skënderbeut në Vajkal

¹¹⁹ Në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut", në skajin jugor të luginës së Vajkalit, me datë 27.05. 2017 është vendosur monumenti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, në kujtim të dy betejave të Vajkalit të udhëhequra dhe të fituara prej Heroit tonë Kombëtar. Monumenti ka lartësi 3.00m dhe gjërësi 2.50m. Është punuar nga studenti i skulpturës nga Vajkali, E. Balja (fig. 39). ***Veprimtaria u organizua nga shoqata "Bulqiza" me kryetar z. Bashkim Lami, me bashkëpunimin e z. Azis Keta, Asllan Daxha, Sami Curri, Geri Emiri si dhe një grup i biznesit vendor.***

Ndalohet kopjimi i këtij materiali pa lejen e autorit.

bunguria1@gmail.com

© Adem Bunguri